KORRIK PA PLASTIKË

Ndërgjegjësojmë bizneset dhe qytetarët për ndikimin negativ të plastikës në mjedis dhe të promovojmë alternativa të qëndrueshme

Tiranë, 2025

Përgjatë muajit korrik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka zhvilluar takime në një sërë subjektesh tregtare me synim sensibilizimin për mos përdorimin e qeseve plastike dhe produkteve plastike njëpërdorimshe.

✅ Qëllimi ynë është të ndërgjegjësojmë bizneset dhe qytetarët për ndikimin negativ të plastikës në mjedis dhe të promovojmë alternativa të qëndrueshme.

REDUKTO -RIPËRDOR-RICIKLO

Merr dhe ti angazhimin tënd për të zvogëluar ndotjen nga plastika!

🌬 Ne besojmë se përmes bashkëpunimit dhe informimit, mund të ndërtojmë një komunitet më të pastër dhe një të ardhme më të gjelbër.

1. Hyrje

Në kuadër të përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit, ndërmorëm gjatë muajit Korrik 2025, një fushatë sensibilizuese në disa subjekte tregtare në Tiranë, me fokus uljen e përdorimit të qeseve plastike dhe materialeve plastike njëpërdorimshe nga konsumatorët.

Kjo iniciativë synoi ndërgjegjësimin e publikut për ndikimin negativ të mbetjeve plastike në mjedis si dhe nxitjen e sjelljeve të qëndrueshme në përditshmëri, veçanërisht gjatë proçeseve të blerjes. Kjo fushatë vijoi përgjatë muajit korrik për të inkurajuar njerëzit të reduktojnë perdorimin e plastikes njeperdorimshe për një muaj të tërë dhe duke ofruar alternativa të tjera mjedisore të përdorimit të çantave që nxitin zhvillimin e qendrueshëm dhe për të ndihmuar në reduktimin e mbetjeve plastike njëpërdorimshme.

Synimi ishte për të ndërgjegjesuar shitësin dhe blerësin për ndikimin negativ të plastikës në mjedis. Të nxisë zëvendësimin e qeseve plastike me alternativa të qëndrueshme si; qeset prej pëlhure, apo letre. Të ulë ndotjen në dete, lumenj dhe natyrë, ku miliona ton plastikë përfundojnë çdo vit.

2. Qëllimi i fushatës

Ndërgjegjësimi për bizneset dhe qytetarët për mos përdorimin e çantave plastike dhe të produkteve njëpërdorimshe duke patur parasysh rrezikun dhe ndikimin e tyre në mjedis.

Qëllimet kryesore:

- Të reduktohet përdorimi i plastikave njëpërdorimshe në pikat e shitjeve;
- Të promovohet përdorimi i çantave shumëpërdorimshe apo alternativave të riciklueshme;
- Të promovohet përdorimi i aksesorëve (si gota, pirunj, pjata, luge, pipza etj) me materiale të riciklueshme dhe jo plastike
- Të rritet ndërgjegjësimi i konsumatorëve për ndikimin mjedisor të plastikës;
- Të forcohet angazhimi i tyre në zbatimin e praktikave të mira mjedisore.

3. Aktivitetet e realizuara

Gjatë kësaj fushate janë realizuar:

- Takime ndërgjegjësuese me 342 subjekte tregtare në Tiranë.
- Vendosja e materialeve informuese në ambientet e brendshme të marketeve.
- Komunikim i drejtpërdrejtë me stafin menaxherial, me arken ose direkt me shitesin ambulant me qëllim informimin dhe nxitjen e përdorimit të çantave alternative dhe zevendesimin me materiale te ricikluesshme e te biodegradueshme. Reduktimi i produkteve plastike njëpërdorimshe që përdoren për shitje.
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve/blerësve të rastit, gjatë realizimit të takimeve me bizneset.
- Informimi i bizneseve se trashesia e qeseve plastike te lejuara eshte mbi 70 mikron. Kjo do te thote se vetem qeset e trasha dhe te riperdorshme jane te lejuara. Qeset duhet te jene te biodegradueshme ose te ricikluesshme, dhe me përmbajtje te ulet plastike. Qeset duhet te shiten me pagese dhe jo te shperndahen falas nga dyqanet në mënyrë që blerësit të nxiten për të marrë çantat e tyre me vete.

Momente gjatë takimeve ndërgjegjësuese

Superdry.

AIUTO?
Tatto

Kinder

4. Rezultatet dhe ndikimi

Nga të dhënat e mbledhura gjatë periudhës së zbatimit të fushatës, janë vërejtur këto rezultate:

- Është shënuar një ulje në përdorimin e qeseve plastike dhe plastikave njeperdorimshe duke qene se subjektet e medha te qytetit jane te gjitha me tregtim te qeseve brenda standartit te lejuar
- Raportohet nga stafi i subjekteve rritje te klientëve që sjellin çantat e tyre shumëpërdorimshe.
- Stafi i subjekteve raportoi një rritje të ndërgjegjësimit dhe gatishmërisë për të promovuar praktika të qëndrueshme.
- Subjektet tregtare kryesisht përdorin qese plastike me trashësi me e madhe se 70 mikron në zbatim të legjislacionit në fuqi, qese letre dhe çanta cope.
- Ne dyqanet e fruta perimeve dhe disa markete perdoreshin pervec qeseve te permasave mbi 70 mikron, edhe qese rulo dhe njeperdorimshe.
- Feedback-u nga konsumatorët ka qenë kryesisht pozitiv dhe inkurajues.

5. Sfidat e hasura

Gjatë zbatimit të fushatës janë identifikuar disa sfida:

- Mungesë e njohurive të mjaftueshme te një pjesë e konsumatorëve për alternativat ndaj plastikës;
- Veshtiresi ne disa subjekte me mos deshire per bashkepunim.

6. Përfundime

Fushata e ndërgjegjësimit për reduktimin e përdorimit të plastikes ka dhënë një impakt pozitiv, duke treguar se angazhimi i përbashkët i biznesit dhe qytetarëve mund të sjellë ndryshim të prekshëm për mjedisin.

7. Rekomandime

Në vijim të fushates ndergjegjesimit dhe rezultateve të arritura, rekomandojmë:

- Të institucionalizohet zbatimi i masave për reduktimin e plastikës si pjesë e politikës së përhershme të kompanive;

- Të mbështetet sektori privat me stimuj për prodhimin dhe shpërndarjen e alternativave ekologjike;
- Te mbeshteten subjektet nga furnizuesit me aksesore vetem ekologjik dhe të biodegradueshem.
- Ofrimi i zbritjeve simbolike ose bonuseve për klientët që zgjodhën të mos përdorin qese plastike.
- Nevoja për më shumë mbështetje logjistike ndaj bizneseve për të ofruar produkte zëvendësuese të qëndrueshme me kosto të ulët.
- Postime sensibilizuese në rrjetet sociale të kompanisë (nëse aplikon).
- Të sigurohet trajnimi i mëtejshëm i stafit për komunikim efektiv mbi çështjet mjedisore.
- Të zgjerohet fushata ndergjegjësuese edhe në:
    - ✓ Qytete te tjera të Shqipërisë
    - ✓ Kompanitë prodhuese të plastikës njëperdorimshme
    - ✓ Shkolla publike për reduktimin e perdorimit te produkteve plastike njeperdorimshe

Përgatiti dhe publikoi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

***Adresa**: Rruga "Sami Frashëri" Nr. 4, Tiranë;*

***Web**: www.akm.gov.al*